




Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

# RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË GLLOGOCIT PËR VITIN 2020

Prishtinë, korrik 2021

## PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

### Shënim

Ky Raport i auditimit është gjeneruar për herë të parë përmes platformës elektronike për menaxhimin e auditimit (SITA). Po ashtu, këtë vit, përdoret shablloni i ri i Raportit të auditimit, sipas metodologjisë së përditësuar për auditime financiare dhe të pajtueshmërisë. Raporti përfshinë për herë të parë edhe konkluzionin e veçantë për pajtueshmëri.

Jemi plotësisht të vetëdijshëm që aplikimi i të gjitha këtyre risive njëkohësisht, në rrethana të pazakonshme të pandemisë, mund të rezultojë me ndonjë lëshim të paqëllimshëm teknik, për çka ju kërkojmë falje paraprakisht dhe ju falënderojmë për mirëkuptim!

Për: Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës së Gllgocit

Adresa: Rr. "Fehmi Lladrovci" , Gllgoc, Republika e Kosovës

## 1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Gllgocit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.<sup>1</sup>

### Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Gllgocit (GLL), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera<sup>2</sup>, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Gllgocit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

### Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

### Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar gjithashtu pajtueshmërinë e menaxhmentit të Komunës së Gllgocit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të GLL kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e

audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

## Baza për konkluzion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

## Theksimi i Çështjes

- 1 Për vëmendjen tuaj, dëshirojmë të theksojmë faktin se si rezultat i buxhetimit të gabuar, Komuna kishte bërë pagesa në shumë prej 163,138€ nga kategoritë jo adekuate, prej të cilave nga Investimet kapitale: 145,138€ ishin paguar për Mallra e shërbime, me ç'rast ishte mbivlerësuar kategoria e Investimeve kapitale dhe nënvlerësuar kategoria e Mallrave dhe shërbimeve; 18,000€ ishin paguar për Subvencione e transfere. Si rezultat, për të njëjten shumë ishte mbivlerësuar kategoria e Investimeve kapitale dhe nënvlerësuar kategoria e Subvencioneve e transfereve; dhe 55,460€ për Subvencione e transfere (për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për qytetarët) ishin paguar nga Mallrat dhe shërbimet, duke rezultuar me mbivlerësim të Mallrave dhe shërbimeve dhe nënvlerësim të Subvencioneve dhe transfereve për të njëjten shumë.

Përveç kësaj, Komuna kishte bërë edhe pagesa tjera në bazë të vendimeve gjyqësore në shumë prej 157,864€ për kompensimin e pagave jubilarë, pagave përcjellëse, shujtave dhe shpenzimet tjera të procedurave gjyqësore, përkatësisht keto shpenzime janë paguar nga Mallrat dhe Shërbimet. Rrjedhimisht, për të njëjtën shumë, ishte mbivlerësuar kategoria e Mallrave e shërbimeve dhe nënvlerësuar kategoria e Pagave dhe mëditjeve.

Kjo kishte ndodhur për arsyen se:

1. Me rastin e aprovimit të Ligjit për ndarjet buxhetore të vitit 2020, këto shpenzime ishin planifikuar dhe ekzekutuar në kategori jo adekuate ekonomike; dhe
2. Për shkak të mungesës së fondeve buxhetore, të cilat me rastin e ndarjeve buxhetore nga Qeveria, përkatësisht Ministria e Financave, detyrimet për paga në bazë të vendimeve gjyqësore nuk ishin marrë parasysh si detyrime rrjedhëse gjatë vitit dhe rrjedhimisht, nuk ishte ndarë asnjë fond kontigent për kompensimin e tyre. Thesari kishte ekzekutuar pagesat nga fondet e ndara për kategoritë tjera.

Duke qenë se çështjet në fjalë janë mjaft të përhapura në shumë organizata buxhetore dhe po përsëriten për vite me radhë, ato do të trajtohen më hollësisht

në Raportin e auditimit të Pasqyrave Financiare të Qeverisë, ku edhe do të jepen rekomandimet përkatëse për zgjidhje afatgjatë.

Opinionin e auditimit nuk është modifikuar për shkak të kësaj çështje.

### **Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore**

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Glllogocit.

### **Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë**

Menaxhmenti i Komunës së Glllogocit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Glllogocit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.<sup>3</sup>

### **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Glllogocit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunes së Gllgocit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.


Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

## 2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve (shih Grafikonin 1) dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i shqyrtojmë këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Grafiku 1. Lloji i gjetjeve sipas kategorive ekonomike<sup>4</sup>



Ne po ashtu, kemi rishikuar statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe kemi vlerësuar nivelin e zbatimit të tyre. [Për detajet shih kapitullin 4].

## 2.1 Gjetjet për çështjet e menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

### 2.1.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga komuna në vitin 2020 ishin 885,917€ apo rreth 20% më pak se vitin paraprak. Të hyrat kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj. Komuna kishte edhe të hyra të arkëtuara nga institucionet tjera në emër të komunës si në vijim: gjobat në trafik 408,168€ dhe gjobat nga gjykatat 4,096€. Për qëllime ekzaminimi, ne kemi shqyrtuar 12 mostra për teste substanciale në vlerë 31,903€.

#### Çështja A1 - Vonesa në deponimin e parasë së gatshme në llogarinë bankare

**Gjetja** Neni 11 i Rregullës Financiare 03/2010 për të hyrat përcakton që paratë e grumbulluara nga Organizatat Buxhetore (OB) nga arkëtimet për shërbime në lartësi deri 10€, duhet në fund të ditës të depozitohen në llogarinë bankare.

Në tri raste kemi evidentuar se paratë e arkëtuara në zyrat e gjendjes civile, administratë si dhe participimi në QKMF, nuk ishin depozituar me kohë në arkë, rrjedhimisht në bankë. Vonesat ishin nga dy ditë deri afërsisht një muaj, ndonëse vlerat monetare nuk ishin materiale. Përkatësisht:

Të hyrat e arkëtuara për çertifikata në zyrën e gjendjes civile në Arllat nga data 04.08.2020-31.08.2020 në vlerë 238€; në zyrën e gjendjes civile në Komoran nga data 25.08.2020-01.09.2020 në vlerë 164€; dhe në administratë nga data 31.08.2020-01.09.2020, në vlerë 237€, të gjitha në vlerë totale 639€ ishin deponuar në bankë me datë 02.09.2020.

Të hyrat e arkëtuara për taksa për regjistrimin e automjeteve në administratë nga data 16.12.2020-17.12.2020 në vlerë 890€ ishin deponuar në bankë me datë 18.12.2020.

Të hyrat e arkëtuara nga participimi në shëndetësi nga data 06.10.2020-12.10.2020, në vlerë 1,519€ ishin deponuar në bankë me datë 12.10.2020.

Kjo ka ndodhur si shkak i kontrolleve të brendshme jo efektive përkatësisht rrethanave vështirësuese në organizimin e stafit.

**Ndikimi** Mos deponimi me kohë i mjeteve në llogarinë bankare, mund të rritë rrezikun e humbjes apo edhe keq përdorimit të parasë së gatshme.

**Rekomandimi A1** Kryetari të sigurojë përmirësimin e kontrolleve të brendshme në mënyrë që paratë e gatshme të grumbulluara të dorëzohen me kohë në arkë dhe të depozitohen në bankë në harmoni me kërkesat e rregullës financiare për të hyrat.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja A2 - Dobësi në procesin e veprimtarive inspektuese të objekteve brenda territorit të Komunës**

**Gjetja** Sipas nenit 15.2 të Ligjit Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, veprimtaritë inspektuese kryhen çdo vit për të paktën njëzetë përqind (20%) të të gjitha objekteve brenda territorit të Komunës.

Komuna në vitin 2020 nuk ka arritur të plotësoj kriterin e kryerjes së veprimtarive inspektuese, ngase nga totali 12,213 i objekteve të regjistruara janë verifikuar 1,510 objekte apo rreth 12%.

Kjo ka ndodhur si shkak i dobësive në organizimin e veprimtarive inspektuese, por edhe si rezultat i ndikimit të pandemisë dhe vështirësive tjera në organizmin e stafit.

**Ndikimi** Mos verifikimi i objekteve mund të rezultojë me mangësi të informacionit aktual rreth data bazës së tatimit të pronë dhe mund të ndikojë negativisht në rrejdhën e të hyrave.

**Rekomandimi A2** Kryetari të sigurojë përmirësimin e procesit të organizmit të veprimtarive inspektuese sipas kriterëve ligjore të përcaktuara në mënyrë që ndryshimet eventuale nga ispektimet të jenë regjistruar, ashtu që shënimet rreth tatimit në pronë të janë të plota.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.1.2 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime dhe komunalitë në vitin 2020 ishte 2,234,429€, prej të cilave ishin shpenzuar 1,556,659€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me shërbime kontraktuese, shërbime komunale, furnizime të ndryshme për zyre, mirëmbajtjen e objekteve dhe pajisjeve etj. Kemi testuar 16 mostra për teste substanciale në vlerë 339,509€ si dhe pesë (5) mostra për teste (procedura) të pajtueshmërisë.

### Çështja A3 - Dobësi në përmbushjen e kriterit të dosjes së tenderit lidhur me vërtetimin tatimor

#### Gjetja

Në dosje të tenderit dhe te njoftimi për kontratë, te kushtet për pjesëmarrje respektivisht te kërkesat e përshtatshmërisë, ishte përcaktuar si kriter "Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore e vendit Tuaj të themelimit se Ju nuk jeni në vonesë për pagimin e tatimeve. Ky vërtetim duhet të jetë jo më i vjetër se 90 ditë kalendrike nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, duhet të dorëzohet nga Operatori Ekonomik të cilit synohet dhënia e kontratës".

Te aktiviteti i prokurimit përkatësisht te kontrata "Inventarizimi i shkollave - faza e dytë", në vlerë 115,800€, te njëri nga grupi i operatorëve ekonomik, kemi identifikuar se vërtetimi tatimor ishte prezantuar me validitet të skaduar përtej afatit 90 ditor nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, dhe jo në përputhje me datën në sistemin elektronik të Administratës Tatimore të Kosovës.

Kjo ka ndodhur si rezultat i kontrolleve të brendshme jo efikase në procesin vlerësimit të tenderëve dhe dhënies së kontratës konform kriterëve të përcaktuara në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë.

#### Ndikimi

Mangësitë e identifikuara rreth mos plotësimit të kërkesave të përshtatshmërisë në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë, lidhur me vërtetimin tatimor mund të reflektojnë negativisht në përzgjedhjen e operatorit të përgjegjshëm ekonomik dhe në përmbushjen e drejtë të kontratës konform kushteve kontraktuese.

#### Rekomandimi A3

Kryetari të sigurojë përmirësimin e kontrolleve të brendshme në procesin e vlerësimit dhe përzgjedhjes së tenderëve konform kriterëve të përcaktuara në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 2.1.3 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 508,922€, dhe prej tyre në 2020 ishin shpenzuar 430,331€. Ato janë dhënë për entitete publike dhe jopublike dhe kanë të bëjnë kryesisht me përkrahjen e sektorit të bujqësisë, kulturës, sportit dhe aktiviteteve tjera në kuadër të komunës. Në këtë fushë kemi testuar pesë (5) mostra për teste substanciale në vlerë 147,142€ si dhe pesë (5) mostra për teste të pajtueshmërisë.

#### Çështja A4 - Mos respektim i kriterëve gjatë vlersimit të aplikacioneve

**Gjetja** Sipas thirrjes publike të dt. 07.05.2020 për ofrimin e mbështetjes financiare për fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, ishte kërkuar kriteri për aplikim se “Pas nënshkrimit të kontratës duhet të paraqesë prova se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale”.

Nga testimi i thirrjes publike për financimin e projekteve të OJQ-ve dhe individëve në fushën e sportit dhe kulturës, kemi identifikuar dhjetë (10) raste në të cilat përfituesit janë shpërblyer me kontratë për mbështetje financiare, përderisa në dosjet e përfituesve mungonte dëshmia se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale.

Kjo gjendje ishte si pasojë e asaj se kriteri lidhur me provat për veprat penale ishte kërkuar pas nënshkrimit të kontratës derisa kjo ishte dashur të kerkohej para nënshkrimit të kontratës me përfituesit e subvencioneve.

**Ndikimi** Mungesa e dokumenteve për përmbushjen kriterëve në procesin e vlerësimit të aplikantëve, përveç që mund të dëmtoj kredibilitetin e procesit, mund të rezultojë që komuna të bashkëpunon me OJQ/individë të pa përshtatshëm.

**Rekomandimi A4** Kryetari, duhet t'i forcojë kontrollet mbi menaxhimin e subvencioneve dhe të siguroj që, fillimisht, kriteret e vendosura në thirrjet publike hartohen konform kërkesave dhe udhëzuesve të nivelit qendror dhe atij lokal që rregullojnë këtë fushë. Pastaj, të siguroj se subvencionet ndahen në përputhje me kriteret e vendosura në thirrje publike.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.1.4 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 6,822,776€ (ndërsa buxheti i alokuar ishte 6,569,562), prej tyre në 2020 ishin shpenzuar 5,071,378€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me ndërtim dhe rregullim të infrastrukturës rrugore, ujësjellësit dhe kanalizimeve, ndërtim të shkollave dhe parqeve, shpronësime, blerje të pajisje dhe përmirësime të ndryshme të kapitalit. Ne kemi testuar 62 mostra për teste substanciale në vlerë 2,542,296€, si dhe pesë (5) mostra për qëllime të pajtueshmërisë.

### Çështja B1 - Mungesa e projektit ekzekutues

**Gjetja** Neni 20.10 i RrUOPP kërkon që specifikat teknike për kontratën e punës, duhet të përfshijnë një projekt ekzekutues si pjesë substanciale të veten.

Ne kemi identifikuar se në 24 kontrata pune, komuna nuk kishte hartuar projektin ekzekutues, por i kishte zhvilluar procedurat e prokurimit duke përgatitur vetëm paramasën dhe paralogarinë. Mungesa e projekteve ekzekutuese kryesisht ishte te ndërtimi i rrugëve dhe kanalizimeve.

Komuna kishte kontratë me një operator për hartimin e projekteve, mirëpo nuk ishte e kënaqur me cilësinë e projekteve të marra nga operatori, prandaj procedurat e prokurimit janë zhvilluar vetëm me paramasë dhe paralogari.

**Ndikimi** Mungesa e projekteve ekzekutuese dhe inicimi i procedurave për projekte kapitale vetëm me paramasë dhe paralogari, rritë rrezikun që gjatë procesit të ekzekutimit të projekteve të paraqiten pengesa të ndryshme si në aspektin profesional, ashtu edhe në vonesat e punimeve apo edhe në rritjen e kostove të projekteve.

**Rekomandimi B1** Kryetari duhet të sigurojë se për të gjitha aktivitetet e prokurimit që kanë të bëjnë me punë, të mos iniciohen procedurat pa u siguruar specifika të qarta sipas projektit ekzekutues të cilat do të ndikonin në eliminimin e vonesave dhe të kostove shtesë.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

#### Çështja B2 - Ndryshime në pozicionet e kontratave pa aprovimin paraprak të ZKA-së

**Gjetja** Neni 61.21 RrUOPP specifikon se “Ndryshimi i kontratës i referohet një ndryshimi në termat dhe kushtet e një kontrate të shpërblyer”, dhe neni 61.22 thotë se “ndryshimi i kontratës do të përgatitet nga departamenti i prokurimit”, ndërsa neni 61.23 thotë se kjo mund të bëhet “vetëm pas marrjes së aprovimit nga Zyrtarit Kryesor Administrativ”.

Gjatë testimit të pagesave ne kemi identifikuar katër (4) kontrata në të cilat kishte pasur devijime apo ndryshime të sasive të realizuara nëpër disa pozicione, duke rritur apo zvogëluar sasinë e kontraktuar (me reflektim financiar prej 2€ deri në 3,033€), por pa rritur çmimin total të kontratës. Për këto ndryshime nuk ishin marrë aprovimet e nevojshme nga zyra e prokurimit dhe nga ZKA ashtu siç kërkohet me nenet 61.22 dhe 61.23 të RrUOPP.

Përkatësisht kontratat:

- "Rregullimi i rrjetit të kanalizimeve në fshatrat Baice, Krajkovë dhe Damanak" ndryshimet e sasive janë identifikuar në tetë (8) pozicione;
- Lot 1 "Rregullimi i rrjetit të kanalizimit në fshatrat Shtuticë dhe Verbovc", në 20 pozicione;
- "Kanalizimi i ujerave të zeza në Komunën e Drenasit - faza e dytë" në nëtë (9) pozicione; dhe
- "LOT II Rregullimi i rrjetit të kanalizimit në fshatrat Abri dhe Terdec" në 15 pozicione.

Nevoja për ndryshime kishte ardhur për shkak të mungesës së projekteve ekzekutive dhe kërkesave të banorëve lokal për ndryshime specifike sipas nevojave të tyre. Duhet theksuar se dukuria e mangësive të tilla në menaxhimin e kontratave ishte paraqitur edhe në raportin e auditimit të vitit paraprak.

#### **Ndikimi**

Ekzekutimi i punëve në kundërshtim me paramasën dhe paralogarinë e kontraktuar pa aprovimin e ZKA-së dhe zyrës së prokurimit, shpërfaq dobësitë në kontrollet e ushtruara nga menaxhmenti. Kjo mund të ndikojë në cilësinë e punëve të kryera si dhe në përmbushjen e kontratës sipas objektivave të përcaktuara.

#### **Rekomandimi B2**

Kryetari duhet të sigurojë se çdo ndryshim në kushtet e kontratës para ose gjatë periudhës së zbatimit do të bëhet vetëm pas njoftimit dhe marrjes së aprovimin nga zyra e prokurimit dhe ZKA.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.1.5 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 510,733,130€, pasurive jokapitale është 677,041€, si dhe e stoqeve 4,202€. Në këtë fushë, kemi testuar 70 mostra për teste substanciale në vlerë 12,617,224€, si dhe kemi kryer teste të pajtueshmërisë lidhur me procedurat e brendshme të menaxhimit të pasurive, inventarizimin dhe vlerësimin e pasurive, funksionimin e sistemit e-pasuria etj.

### Çështja B3 - Mangësi në regjistrin kontabël të pasurive si dhe procesin e inventarizimit dhe vlerësimin të pasurive jo financiare

**Gjetja** Neni 6.3 i Rregullores për 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare thotë se: Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK, ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin e-pasuria. Neni 19.4.3 i Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare përcakton se çdo fundvit duhet të bëhet krahasimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen e regjistrave të pasurive jo financiare. Ndërsa neni 21 i po kësaj rregulloreje ka përcaktuar kërkesat për vlerësimin e pasurive jo financiare.

Ne kemi evidentuar 14 pagesa të shpenzimeve kapitale dhe jo kapitale prej 489,283€ të cilat nuk ishin regjistruar në regjistrin e pasurive jo financiare (prej tyre 11 pagesa me vlerë 376,842€ nuk janë regjistruar në SIMFK dhe tre (3) pagesa prej 112,441€ në e-pasuria).

Procesi i inventarizimit të pasurive jo financiare ishte kryer me vonesë, rrejdhimisht nuk ishte bërë krahasimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare para datës së përgatitjes së PFV-ve. Si rezultat, nuk dihet diferenca mes gjendjes së kontabilitetit dhe inventarizimit. Po ashtu, nuk ishte bërë vlerësimi i pasurive jo financiare sipas kërkesave të Rregullores 02/2013.

Sipas zyrtarëve komunal, kjo gjendje ishte për shkak të volumit të madh të punëve në fund të vitit, vonesave në procesin e inventarizimit si dhe mungesës së njohurive lidhur me kërkesat e rregullores për menaxhimin e pasurive, ndonëse kjo çështje është trajtuar edhe në auditimin paraprak.

**Ndikimi** Mungesa e regjistrave të saktë dhe të plotë shkakton mungesë të informatave për menaxhmentin lidhur me pasurinë që posedon komuna, shkakton mbi/nënvlerësim të pasurive si dhe mund të rezultojë në prezantimin jo të drejtë të informatave në pasqyra financiare. Ndërsa, mos krahasimi i rezultateve të inventarizimit me gjendjen e regjistrave të pasurive dhe mos vlerësimi i pasurive, pamundëson marrjen e sigurisë lidhur me saktësinë dhe plotësinë e

regjistrave të pasurisë.

**Rekomandimi B3** Kryetari, duhet të sigurohet që do të bëhet azhurnimi i regjistrit të pasurive kapitale konform gjetjeve të auditimit të trajtuara me lartë për të siguruar se të gjitha pasuritë e komunës janë identifikuar dhe regjistruar saktë në regjistrat përkatës të pasurive komunale. Po ashtu duhet siguruar se procesi i inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive do të kryhet sipas kërkesave të Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore, si dhe më pas, të bëhet krahasimi i rezultateve të inventarizimit me gjendjen kontabël të pasurive, duke i sqaruar të gjitha diferencat.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.1.6 Të arkëtueshmet

Komuna në PFV e vitit 2020 ka shpalosur Llogari të Arkëtueshme (LLA) në vlerë prej 3,343,163€. Kjo vlerë përbehet nga të arkëtueshmet e tatimit në pronë, taksa në biznes, shfrytëzimi i pronës publike si dhe lejet ndërtimore. Gjithsej kemi testuar 35 mostra për teste substanciale në vlerë 662,298€.

### Çështja B4 - Dobësi në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme (LLA)

**Gjetja** Arkëtimi i të hyrave bëhet sipas afateve kohore të përcaktuara në faturë për secilin lloj të të hyrave.

Pjesa më e madhe e LLA i takon tatimit në pronë në vlerë 1,656,643€ apo rreth 49,55%, taksa komunale në biznes në vlerë 1,304,801€ apo rreth 39%, shfrytëzimi i pronës publike (qiraja) në vlerë 356,459€ rreth 10.66% si dhe për leje ndërtimore në vlerë 25,260 rreth 0.76%. Komuna nuk kishte menaxhim efektiv në mbledhjen e të arkëtueshmeve pasi që vazhdon rritja e tyre vit pas viti. Në krahasim me vitin paraprak rritja ishte rreth 193,697€.

Rritja e llogarive të arkëtueshme vit pas viti ishte për shkak të mos marrjes së të gjitha veprimeve të mundshme për arkëtimin e tyre. Ndonëse niveli i arkëtimin ishte edhe si rezultat i ndikimit të pandemisë, gjithashtu komuna kishte liruar bizneset nga taksa për ushtrimin e veprimtarisë për vitin 2020.

**Ndikimi** Mos arkëtimi në kohë i të hyrave të ngarkuara ndikon në nivelin e fondeve të mbledhura për buxhetin komunal me refleksion negativ në financimin dhe realizimin e projekteve nga të hyrat vetjake.

**Rekomandimi B4** Kryetari të sigurojë përmirësimin e procesit të menaxhimit të llogarive të arkëtueshme në mënyrë të rritjes së efikasitetit në arkëtimin me kohë të llogarive të arkëtueshme, duke mos përjashtuar edhe masat juridike.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.1.7 Detyrimet kontingjente

Pasqyra e detyrimeve kontingjente në fund të vitit 2020, ishte 252,291€.

### Çështja B5 - Mangësi në listen e detyrimeve kontingjente

**Gjetja** Sipas Rregullores së MF-Nr.01/2017 Për Pasqyrat Financiare të Organizatave Buxhetore, neni 18 përcakton se: Organizatat Buxhetore në harmoni me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP) raportojnë të gjitha detyrimet kontingjente.

Kemi evidentuar tre (3) raste në shumë 6,607€ të cilat në listën e detyrimeve kontingjente nuk kishin të përcaktuar vlerën financiare, rrjedhimisht vlera e detyrimeve kontingjente e shpalosur në PFV ishte e nënvlerësuar për këtë vlerë. Po ashtu, në kuadër të detyrimeve kontingjente, ishin përfshirë edhe detyrimet prej 78,674€ për të cilat ekzistonte një vendim i formës së prerë nga ana e gjykatave lidhur me to dhe se pritej vetëm ekzekutimi i pagesave nga Thesari.

Kjo gjendje ishte për shkak të mungesës së komunikimit të mirëfilltë mes zyrtarëve ligjor të komunës dhe Avokaturës Shtetërore (si përfaqësues i komunës) dhe sektorëve tjerë brenda komunës për evidentimin dhe regjistrimin e saktë të detyrimeve kontingjente.

**Ndikimi** Mos regjistrimi dhe evidentimi i saktë i listës së detyrimeve kontingjente mund të krijoj paqartësi për komunën lidhur me pretendimet e palëve tjera ndaj detyrimeve komunale. Po ashtu, ndikon në mbivlerësimin apo nënvlerësimin e tyre në PVF.

**Rekomandimi B5** Kryetari duhet të sigurohet se zyra ligjore dhe e financave bashkëveprojnë në mënyrë sistematike me Avokaturën Shtetërore për të siguruar shpalosje të plota dhe të sakta të detyrimeve kontingjente.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.1.8 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) kishte drejtorin dhe një anëtar. Përveç planit strategjik, NjAB kishte hartuar edhe planin vjetor të punës ku ishin përfshirë gjashtë (6) auditime, të cilat edhe ishin realizuar gjatë vitit 2020. Numri i rekomandimeve të dhëna në raportet e auditimit është 37, prej të cilave të zbatuara ishin 18, në proces ishin 12 dhe shtatë (7) të pazbatuara. Auditimet ishin fokusuar në fushën e prokurimit, rishikimin e proceseve të shpenzimeve si dhe në fushën e të hyrave, menaxhimin me pronat komunale dhe pasuritë jo financiare të komunës, përderisa periudha e mbuluar me auditim ishte kryesisht viti 2019. Komiteti i auditimit ishte funksional dhe kishte mbajtur katër (4) takime, ku ishte diskutuar për raportin e auditorit të jashtëm dhe të NjAB.

### Çështja B6 - Mos kompletimi i NjAB

- Gjetja** Neni 5.1.1 i Rregullores 01/2019 për themelimin e Njesisë së Auditimit të Brendshëm përcakton që çdo subjekti i sektorit publik me buxhet mbi shtatë (7) milion euro duhet të ketë së paku tre auditorë.
- NjAB në Komunën e Glllogocit përbëhet nga drejtori dhe një anëtar. Kjo gjendje ishte për shkak mungesës së buxhetit të ndarë për plotësimin e numrit minimal të auditorëve sipas kërkesave ligjore.
- Ndikimi** Mos kompletimi i NjAB-së me staf të mjaftueshëm, mund të ndikojë që auditimi i brendshëm mos të mbulojë të gjitha fushat me rrezik, dhe t'i pamundësoj menaxhmentit marrjen e veprimeve me kohë për parandalimin e gabimeve të mundshme.
- Rekomandimi B6** Kryetari, duhet të sigurojë se për pozitat e kërkuara do të bëhen planifikimet buxhetore me kohë dhe se NjAB të plotësohet me staf të mjaftueshëm sipas rregullores për themelimin e NjAB.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Ne kemi marrë parasysh burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të ardhurave të mbledhura nga kategoritë ekonomike. Kjo është theksuar në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final <sup>5</sup>	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
<b>Burimet e fondeve</b>	<b>16,490,344.00</b>	<b>18,125,997.54</b>	<b>15,583,237.76</b>	<b>14,633,793.99</b>	<b>13,901,613.03</b>
Grante Qeveritare Buxheti	15,099,554.00	15,125,742.03	13,832,852.39	13,065,168.95	12,498,679.29
Financimi përmes huamarrjes	0.00	132,725.00	116,582.95	37,904.79	26,635.88
Të bartura nga viti i kaluar	0.00	1,125,676.61	571,822.28	569,329.50	373,453.38
Të hyrat vetanake	1,390,790.00	1,390,790.00	716,372.03	732,609.90	996,864.48
Donacionet vendore	0.00	22,563.87	20,350.62	22,690.85	5,980.00
Donacionet e jashtme	0.00	328,500.03	325,257.49	206,090.00	0.00

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 1,635,654€. Kjo rritje ishte rezultat i të hyrave të bartura nga viti paraprak për 1,125,677€, donacioneve të jashtme për 328,500€, rritjes së donacioneve të brendshme për 22,564€, rritjes së financimit nga huamarrja prej 132,725€, si dhe rritjes së grantit qeveritar për 26,188€.

Në vitin 2020 OB ka shpenzuar 86% të buxhetit përfundimtar në 2020 ose 15,583,237€, me një ulje 11% në krahasim me vitin 2019.

Shpenzimet gjatë vitit 2020 për menaxhimin e pandemisë Covid-19 ishin 611,421€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me kompensimin e pagave të stafit sipas vendimeve të nivelit qendror, shërbimeve tjera kontraktuese, përkrahjen e familjeve dhe bizneseve me pako ushqimore/financiare, pajisje nën 1,000€, furnizime të ndryshme mjekësore etj. Zbatimi i buxhetit dhe shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	16,490,344.00	18,125,997.54	15,583,237.76	14,633,793.99	13,901,613.03
Pagat dhe mëditjet	8,440,641.00	8,524,870.04	8,524,870.04	8,150,885.21	8,088,930.96
Mallrat dhe shërbimet	1,793,264.00	2,013,556.98	1,361,893.26	1,506,214.67	1,281,894.49
Komunalitë	195,340.00	220,872.16	194,765.78	187,251.77	150,368.47
Subvencionet dhe transferet	270,000.00	508,922.68	430,330.64	245,478.88	232,616.27
Investimet Kapitale	4,686,930.00	6,822,775.68	5,071,378.04	4,543,963.46	4,147,802.84
Rezervat	1,104,169.00	35,000.00	0.00	0.00	0.00

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

Buxheti final për paga dhe mëditje ishte rritur për 84,229€. Rritja ishte si rezultat i përshtatjeve buxhetore, rishikimit të buxhetit si dhe situatës së krijuar nga pandemia Covid 19;


Buxheti për mallra dhe shërbime ishte rritur për 220,293€. Rritja kishte ndodhur nga granti i qeverisë në kuadër të përshtatjeve buxhetore për menaxhimin e pandemisë prej 200,453€ si dhe nga të hyrat e bartura për 19,840€;

Buxheti për shërbimet komunale ishte zvogëluar për 25,532€ si pasojë e përshtatjeve buxhetore si dhe situatës së krijuar nga pandemia Covid 19;


Buxheti për subvencione ishte rritur për 238,923€. Rritja kishte ndodhur nga rritja e buxhetit sipas vendimeve për menaxhimin e pandemisë për 226,594€ si dhe nga të hyrat e bartura për 12,329€;

Buxheti për investimet kapitale ishte rritur për 2,135,846€, rritja ishte si rezultat i të hyrave të bartura për 1,036,773€, nga rezerva për 950,533€, si dhe pjesa e mbetur nga grantet i performances për 148,540€.

Grafiku 2. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike gjatë periudhës 2018-2020



Grafiku 3. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2020



Të hyrat e realizuara nga komuna në vitin 2020 ishin 885,917€ apo rreth 20% më pak se vitin paraprak. Të hyrat kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj. Komuna kishte edhe të hyra të arkëtuara nga institucionet tjera në emër të komunës si në vijim: gjobat në trafik 408,168€ dhe gjobat nga gjykatat 4,096€.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Pranimet	2019 Pranimet	2018 Pranimet
Totali i të hyrave	1,390,790.00	1,390,790.00	885,916.52	1,110,521.07	1,305,375.20
Të hyrat tatimore	554,947.00	554,947.00	452,717.21	511,163.10	468,693.39
Të hyrat jo tatimore	835,843.00	835,843.00	432,267.56	597,357.97	836,681.81
Të hyrat tjera	0.00	0.00	931.75	2,000.00	

## 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2019 ka rezultuar në 14 rekomandime. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit për vitin 2020, pesë (5) rekomandime janë zbatuar, gjashtë (6) nuk janë adresuar ende dhe tre (3) nuk janë të aplikueshme më, siç është paraqitur më poshtë në Grafikon 4. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shih Tabelën e rekomandimeve nr.4.

Grafiku 4. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2020

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2019	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Pasqyrat Financiare Vjetore	Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit (apo të ridestinohen mjetet kur është e nevojshme dhe e mundshme) dhe që pagesa e regjistrimi i shpenzimeve bëhet në mënyrë strikte sipas kodeve ekonomike adekuate.	Në raportin e vitit 2020 kjo çështje është trajtuar te theksimi i çështjes në kuadër të keqklasifikimeve.	Nuk është i aplikueshëm më
2.	Pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet të sigurojë se janë zbatuar më përpikëri kërkesat ligjore në proceset e rekrutimit të	Gjatë vitit 2020 nuk kemi testuar procedurat e rekrutimit.	Nuk është i aplikueshëm më

		stafit, në mënyrë që të ketë trajtim të barabartë të kandidatëve dhe të pranohen kandidatë meritor në bazë të kualifikimeve, përvojës dhe arritjeve në test dhe në intervistë.		
3.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të sigurojë që njësitë kërkuese parashikojnë në mënyrë më të saktë nevojat për furnizime vjetore dhe në bashkëpunim me departamentin e prokurimit të bëjnë një planifikim të prokurimit duke zbatuar kërkesat ligjore.	Nuk kemi hasur raste të tilla gjatë vitit 2020.	I zbatuar
4.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se për të gjitha aktivitetet e prokurimit hartohen specifika dhe kushte të qarta për të siguruar ekonomicitetin/efikasitetin dhe efektivitetin e blerjeve të realizuara. Po ashtu, të gjitha procedurat që kanë të bëjnë me punë të mos iniciohen pa u siguruar specifika të qarta sipas projektit ekzekutues.	Edhe gjatë vitit 2020 kemi hasur raste të tilla.	Nuk është adresuar
5.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se stafi i caktuar në menaxhimin e procedurave të prokurimit janë në njohuri me kërkesat rregullative ligjore për prokurimin publik dhe se aplikojnë kontrollet në të gjitha fazat e tij.	Nuk kemi hasur raste të tilla gjatë vitit 2020.	I zbatuar
6.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se menaxherët e kontratave dhe organi mbikëqyrës aplikojnë kontrolle efektive në menaxhimin e kontratave dhe pranimin e furnizimeve/punëve si dhe pagesat bëhen vetëm për furnizimet/punët e realizuara.	Raste të tilla kemi hasur edhe në vitin 2020, mirëpo ishin rregulluar gjatë ekzekutimit të auditimit.	I zbatuar
7.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë që kontratat e nënshkruara të përmbajnë çmimet e sakta dhe devijimet e lejuara, si dhe të kërkojë nga zyrtarët përgjegjës që mos të tejkalohen devijimet përtej limiteve të devijimit të përcaktuara me kontratën publike kornizë.	Nuk kemi hasur raste të tilla gjatë vitit 2020.	I zbatuar


8.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se çdo ndryshim në kushtet e kontratës para ose gjatë periudhës së zbatimit do të bëhet vetëm pas njoftimit të zyrës së prokurimit dhe marrjes së aprovimit nga zyra e prokurimit dhe ZKA konform procedurave të parapara me ligjin dhe rregullat e prokurimit.	Edhe gjatë vitit 2020 kemi hasur raste të tilla.	Nuk është adresuar
9.	Çështjet e përbashkëta	Kryetari, duhet të sigurojë kontrolle shtesë të monitorimit në mënyrë që të gjitha furnizimet dhe punët të pranohen sipas kushteve të kontraktuara, dhe në rastet e pajustificuara të vonesave në liferim të mallit/kryerje të punëve, të aplikohen ndëshkimet e përcaktuara me kontratë.	Nuk kemi hasur raste të tilla gjatë vitit 2020.	I zbatuar
10.	Çështjet e përbashkëta	Kryetari duhet të sigurojë bashkëpunim me MF ashtu që obligimet që dalin nga marrëveshja kolektive të planifikohen/buxhetohen dhe paguhen në kohën e duhur nga kategoria e pagave dhe mëditjeve. Gjithashtu obligimet të paguhen brenda afateve kohore të parapara ligjore sipas LMFPF.	Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet, si dhe investimet kapitale – kjo çështje është trajtuar në kuadër të theksimit të çështjes.	Nuk është i aplikueshëm më
11.	Pasuritë	Kryetari, duhet të sigurohet se të gjitha pasuritë e komunës janë identifikuar dhe regjistruar saktë në regjistrat përkatës të pasurive komunale. Po ashtu duhet siguruar se është bërë krahasimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare dhe në PFV të shpalosen informatat e sakta rreth pasurive.	Edhe gjatë vitit 2020 kemi hasur në pasuri të pa regjistruara dhe mangësi në procesin e inventgarizimit/vlerësimit.	Nuk është adresuar
12.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari, duhet të sigurojë efikasitet më të lartë në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme. Hartimi dhe aplikimi i programeve dhe procedurave të qarta për mënyrën e menaxhimit dhe arkëtimit të tyre, do të ndihmonte në këtë drejtim	Edhe gjatë vitit 2020 kemi evidentuar rritje të llogarive të arkëtueshme.	Nuk është adresuar

13.	Detyrimet Kontigjente	Kryetari duhet të sigurohet se zyra ligjore dhe e financave bashkëveprojnë në mënyrë sistematike për të siguruar shpalosje të plota dhe të sakta të detyrimeve kontigjente.	Edhe në vitin 2020 kemi hasur mangësi në vlerën e detyrimeve kontigjente të shpalosur në PFV.	Nuk është adresuar
14.	Auditimi i Brendshëm	Kryetari, duhet të sigurojë se për pozitat e kërkuara do të bëhen planifikimet buxhetore me kohë dhe se Njësia e Auditimit të Brendshëm do të plotësohet me staf të mjaftueshëm sipas rregullores në fuqi.	Gjendja është e njëjtë edhe në vitin 2020.	Nuk është adresuar


Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020
1.	Të hyrat	Kryetari të sigurojë përmirësimin e kontrolleve të brendshme në mënyrë që paratë e gatshme të grumbulluar të dorëzohen me kohë në arkë dhe të depozitohen në bankë në harmoni me kërkesat e rregullës financiare për të hyrat.
2.	Të hyrat	Kryetari të sigurojë përmirësimin e procesit të organizmit të veprimtarive inspektuese sipas kriterëve ligjore të përcaktuara në mënyrë që shënimet rreth tatimit në pronë të janë të plota.
3.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitetë	Kryetari të sigurojë përmirësimin e kontrolleve të brendshme në procesin e vlerësimit dhe përzgjedhjes së tenderëve konform kriterëve të përcaktuara në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë.
4.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari, duhet t'i forcojë kontrollet mbi menaxhimin e subvencioneve dhe të sigurojë që, fillimisht, kriteret e vendosura në thirrjet publike hartohen konform kërkesave dhe udhëzuesve të nivelit qendror dhe atij lokal që rregullojnë këtë fushë. Pastaj, të sigurojë se subvencionet ndahen në përputhje me kriteret e vendosura në thirrje publike.
5.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se për të gjitha aktivitetet e prokurimit që kanë të bëjnë me punë, të mos iniciohen procedurat pa u siguruar specifika të qarta sipas projektit ekzekutues të cilat do të ndikojnë në eliminimin e vonësave dhe të kostove shtesë.
6.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se çdo ndryshim në kushtet e kontratës para ose gjatë periudhës së zbatimit do të bëhet vetëm pas njoftimit të zyrës së prokurimit dhe marrjes së aprovimit nga zyra e prokurimit dhe ZKA.
7.	Pasuritë	Kryetari, duhet të sigurohet që do të bëhet azhurnimi i regjistrit të pasurive kapitale konform gjetjeve të auditimit të trajtuara me lartë për të siguruar se të gjitha pasuritë e komunës janë identifikuar dhe regjistruar saktë në regjistrat përkatës të pasurive komunale. Po ashtu duhet siguruar se procesi i inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive do të kryhet sipas kërkesave të Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore, si dhe më pas, të bëhet krahasimi i rezultateve të inventarizimit me gjendjen kontabël të pasurive, duke i sqaruar të gjitha diferencat.

8.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari të sigurojë përmirësimin e procesit të menaxhimit të llogarive të arkëtueshme në mënyrë të rritjes së efikasitetit në arkëtimin me kohë të llogarive të arkëtueshme.
9.	Detyrimet Kontigjente	Rekomandimi A6-Kryetari duhet të sigurohet se zyra ligjore dhe e financave bashkëveprojnë në mënyrë sistematike për të siguruar shpalosje të plota dhe të sakta të detyrimeve kontigjente.
10.	Auditimi Brendshëm	Kryetari, duhet të sigurojë se për pozitat e kërkuara do të bëhen planifikimet buxhetore me kohë dhe se NjAB të plotësohet me staf të mjaftueshëm sipas rregullores për themelimin e NjAB.

Besnik Osmani, Auditor i Përgjithshëm



Qerkin Morina, Ndhmës Auditor i Përgjithshëm



Zukë Zuka, Udhëheqës i Auditimit



Ylber Sadiku, Udhëheqës i ekipit



Muharrem Qyqalla, Anëtar i ekipit



Arben Hundozi, Anëtar i ekipit



# Shtojca I: Letër konfirmimi

## Letër konfirmimi

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO			
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT			
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE   NATIONAL AUDIT OFFICE			
Klasiç: 11 01 2021			
Udhëzuesi	Shërbuesi	Re. Prot.	Nr. Shërbuesi
04	47	1205	1

REPUBLIKA E KOSOVËS  
KOMUNA GLOGOC  
MUNICIPAL GLOGOC  
OA Nr. 400/01-32140  
Më Datë 14/07/2021



### Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria-Vlada-Government

Komuna/Opstina/Municipality Drenas (Glogoc)



### LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2020 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Drenasit, për vitin 2020 (në tekstin e mëtejme "Draft -Raporti i Auditimit të Pasqyrave Financiare për vitin fiskal të përfunduar me 31.12.2020");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit, më një kërkesë.
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Ramiraj

(Kryetar i Komitës)

Data: 14.07.2021



## Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare<sup>6</sup> duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet.<sup>7</sup> Ky opinion duhet të veçohet nga opinioni nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, d.m.th. opinionin mund të modifikohet në lidhje me çështjen(t) e pajtueshmërisë, por mund të mos modifikohet në lidhje me besueshmërinë e pasqyrave financiare (ose anasjelltas).

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim(e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

### *Forma e opinionit*

#### Opinionin i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

### Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri.

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

### Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

### Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

**Mohim i opinionit**

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

**Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit**

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

## Shënimet fundore

- <sup>1</sup> Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- <sup>2</sup> Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- <sup>3</sup> Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- <sup>4</sup> Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja  
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura  
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- <sup>5</sup> Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- <sup>6</sup> Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- <sup>7</sup> Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.



REPUBLIKA E KOSOVËS

Komuna e Drenasit

Zyra e Kryetarit

Nr. 01-400-36780

Dt. 09.08.2021



Për: Zyra Kombëtare e Auditimit, z. Besnik Osmani

Nga : Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës së Drenasit



Lënda: Plani i veprimtimit për implementimin e rekomandimeve të Raportit të auditimit me temë: "Raporti i Auditimit për Qasqyrat Financiare vjetore të Komunës së Drenasit për vitin fiskal 2020"

Në pajtim me nenin 14 të Rregullores së punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimtimit, si dhe duke u mbështetur në Procedurat Standarde të Trajtimit të Rekomandimeve të Zyres Kombëtare të Auditimit, po ju dërgojmë Planin e veprimtimit për zbatimin e Rekomandimeve që dalin nga Raporti i auditimit me temën "Raporti i Auditimit për Qasqyrat Financiare vjetore të Komunës së Drenasit për vitin fiskal 2020"

**PLANI I VEPRIMIT**  
**PËR IMPLEMENTIMIN E REKOMANDIMEVE QË DALIN NGA RAPORTI I AUDITIMIT TË PASQYRAVE VJETORE**  
**FINANCIARE TË KOMUNËS SË DRENASIT PËR VITIN FISKAL 2020**

Çështja	E gjetura	Rekomandimi	Veprimet e planifikuara për t'u ndërmarrur	Zyrtari/ët përgjegjës	Afatit
Çështja A1-	<p>Vonesa në deponimin e parasë së gatsh-me në llogarinë bankare. Neni 11 i Rregullës Financiare 03/2010 për të hyrat përcakton që paratë e grumbulluara nga Organizatat Buxhetore (OB) nga arkëtimet për shërbime në lartësi deri 10€, duhet në fund të ditës të depozitohen në llogarinë bankare. Në tri raste kemi evidentuar se paratë e arkëtuara në zyrat e gjendjes civile, administratë si dhe participimi në QKMF, nuk ishin depozituar me kohë në arkë, rrjedhimisht në bankë. Vonesat ishin nga dy ditë deri afërsisht një muaj, ndonëse vlerat monetare nuk ishin materiale. Përkatësisht: Të hyrat e arkëtuara për certifikata në zyrën e gjendjes civile në Arllat nga data 04.08.2020-31.08.2020 në vlerë 238€; në zyrën e gjendjes civile në Komoran nga data 25.08.2020-01.09.2020 në vlerë 164€; dhe në administratë nga data 31.08.2020-01.09.2020, në vlerë 237€, të gjitha në vlerë totale 639€</p>	<p>Kryetari të sigurojë përmirësimin e kontrolleve të brendshme në mënyrë që paratë e gatshme të grumbulluara të dorëzohen me kohë në arkë dhe të depozitohen në bankë në harmoni me kërkesat e rregullës financiare për të hyrat</p>	<p>Tani e tutje, Komuna është duke zbatuar Neni 11. të Rregullorës Financiare 03/2010, ashtu që parat e grumbulluara nga arkëtimet për shërbimet e kryera, brenda ditës është duke i depozituar në llogarin bankare të Komunës. Përmirësimi i kontrolleve është bërë duke i grumbulluar parat e inkasuar brenda ditës në qendrat e gjendjes civile dhe në Sektorin e Shëndetësisë, e më pas po dorëzohen</p>	<p>Shefat e Sektorve dhe pranesit e parave të imta.</p>	<p>Gjatë vitit fiskal 2021.</p>

<p>ishin deponuar në bankë me datë 02.09.2020. Të hyrat e arkëtuara për taksa për regjistrimin e automjeteve në administratë nga data 16.12.2020-17.12.2020 në vlerë 890€ ish in deponuar në bankë me datë 18.12.2020. Të hyrat e arkëtuara nga participimi në shëndetësi nga data 06.10.2020-12.10.2020, në vlerë 1,519€ ish in deponuar në bankë me datë 12.10.2020. Kjo ka ndodhur si shkak i kontrolleve të brendshme jo efektive përkatësisht rrethanave vështirësuese në organizimin e stafit.</p>		<p>në llogarin bankare të Komunës.</p>		
<p><b>Çështja A2-</b> <b>Dobësi në procesin e veprimtarive inspektuese të objekteve brenda territorit të Komunës.</b> Sipas nenit 15.2 të Ligjit Nr. 06/L-005 për Tatinin në Pronën e Paluajtshme, veprimtaritë inspektuese kryhen çdo vit për të paktën njëzetë përqind (20%) të të gjitha objekteve brenda territorit të Komunës. Komuna në vitin 2020 nuk ka arritur të plotësoj kriterin e kryerjes së veprimtarive inspektuese, ngase nga totali 12,213 i objekteve të regjistruara janë verifikuar 1,510 objekte apo rreth 12%. Kjo ka ndodhur si shkak i dobësi në organizimin e veprimtarive inspektuese, por edhe si rezultat i ndikimit të pandemisë dhe vështirësive tjera në organizimin e stafit.</p>	<p>Kryetari të sigurojë përmirësimin e procesit të organizimit të veprimtarive inspektuese sipas kriterëve ligjore të përcaktuara në mënyrë që ndryshimet eventuale nga ispektimet të jenë regjistruar, ashtu që shënimet rreth tatumit në pronë të janë të plota.</p>	<p>Për t'u realizuar kriteri i verifikimit të pronave në normën prej 20% (sipas Ligjit të Tatumit në Pronë Nr. 06/L-005) do të ndëmmarrim këto veprime: -Plotësimi i pozitës së anketuesit (për anketimin-inspektimin e këtyre pronave) -Angazhimi i tërë stafit të ZKTPR, në ndihmë të Anketuesve)</p>	<p>Menaxheri i ZTP dhe Anketuesit.</p>	<p>Afati për t'u kryer këto veprime do të jetë viti 2021-2022.</p>

			<p>-Lirimi i këtyre zyrtarve nga punët dhe detyrat tjera -Krijimi i kushteve për të punuar në teren në dy e më shumë grupe.</p>		
<p>Çështja A3-</p>	<p><b>Dobësi në përmbyshjen e kriterit të dosjes së tenderit lidhur me vërtetimin tatimor.</b>  Në dosje të tenderit dhe te njoftimi për kontratë, te kushtet për pjesëmarrje respektivisht te kërkesat e përshatshmërisë, ishte përcaktuar si kriter "Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore e vendit Tuaj të themelimit se Ju nuk jeni në vonesë për pagimin e tatimeve. Ky vërtetim duhet të jetë jo më i vjetër se 90 ditë kalendarike nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, duhet të dorëzohet nga Operatori Ekonomik të cilin synohet dhënia e kontratës". Te aktiviteti i prokurimit përkatesisht te kontrata "Inventarizimi i shkollave - faza e dytë", në vlerë 115,800€, te njëri nga grupi i operatorëve ekonomik, kemi identifikuar se vërtetimi tatimor ishte prezantuar me validitet të skaduar përtej afatit 90 ditor nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, dhe jo në përputhje me datën në sistemin elektronik të Administratës Tatimore të Kosovës. Kjo ka ndodhur si rezultat i</p>	<p>Kryetari të sigurojë përmirësimin e kontrolleve të brendshme në procesin e vlerësimit dhe përzgjedhjes së tenderëve konform kriterëve të përcaktuara në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë</p>	<p>Do të kemi kujdes të veçant dhe kontrollo të vazhdueshme që një veprim i tillë të mos përsëritet, nëse shohim dyshime të tjera do të kordinohemi me ATK-në që veprimet e tillë të mos ndodhin dhe të mos ketë tëshime të tilla.</p>	<p>Zyra Komunale e Prokurimit Publik.</p>	<p>Brenda vitit 2021.</p>

<p>kontrolleve të brendshme jo efektive në procesin vlerësimit të tenderëve dhe dhënies së kontratës konform kriterëve të përcaktuar në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë</p>				
<p><b>Çështja A4-</b> <b>Mos respektimi i kriterëve gjatë vlerësimit të aplikacioneve.</b> Sipas thirrjes publike të dt. 07.05.2020 për ofrimin e mbështetjes financiare për fushën e kulturës, rinsë dhe sportit, ishte kërkuar kriteri për aplikim se "Pas nënshkrimit të kontratës duhet të paraqesë prova se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale". Nga testimi i thirrjes publike për financimin e projekteve të OJQ-ve dhe individëve në fushën e sportit dhe kulturës, kemi identifikuar dhjetë (10) raste në të cilat përfituesit janë shpërblyer me kontratë për mbështetje financiare, përderisa në dosjet e përfituesve mungonte dëshmia se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale. Kjo gjendje ishte si pasojë e asaj se kriteri lidhur me provat për veprat penale ishte kërkuar pas nënshkrimit të kontratës derisa kjo ishte dashur të kerkohej para nënshkrimit të kontratës me përfituesit e subvencioneve</p>	<p>Kryetari, duhet t'i forcojë kontrollet mbi menaxhimin e subvencioneve dhe të siguroj që, fillimisht, kriteret e vendosura në thirrjet publike hartohen konform kërkesave dhe udhëzuesve të nivelit qendror dhe atij lokal që rregullojnë këtë fushë. Pastaj, të siguroj se subvencionet ndahen në përputhje me kriteret e vendosura në thirrje publike.</p>	<p>Në vitin 2021, kjo çështje është e rregulluar.</p>	<p>Shefi i Sektorit për K,R,Sport.</p>	<p>Viti 2021.</p>

<p>Çështja B1-</p>	<p><b>Mungesa e projektit ekzekutues.</b> Neni 20.10 i RTUOPP këkon që specifikat teknike për kontratën e punës, duhet të përfshijnë një projekt ekzekutues si pjesë substanciale të veten. Ne kemi identifikuar se në 24 kontrata pune, komuna nuk kishte hartuar projektin ekzekutues, por i kishte zhvilluar procedurat e prokurimit duke përgatitur vetëm paramasën dhe paralogarinë. Mungesa e projekteve ekzekutuese kryesisht ishte te ndërtimi i rrugëve dhe kanalizimeve.</p>	<p>Kryetari duhet të sigurojë se për të gjitha aktivitetet e prokurimit që kanë të bëjnë me punën, të mos iniciohen procedurat pa u siguruar specifika të qarta sipas projektit ekzekutues të cilat do të ndikojnë në eliminimin e vonesave dhe të kostove shtesë.</p>	<p>Drejtorati i Infrastrukturës Publike do marrë të gjitha masat që të përzgjidhet një operator më i përgjegjshëm pasi operatorit për hartimin e projekteve i ka skaduar kontrata .</p>	<p>Zyra e Prokurimit dhe Drejtoria përkatëse</p>	<p>Viti 2021-2022</p>
<p>Çështja B2-</p>	<p><b>Ndryshime në pozicionet e kontratave pa aprovimin paraprak të ZKA-së.</b> Neni 61.21 Rr.UOPP specifikon se “Ndryshimi i kontratës i referohet një ndryshimi në termat dhe kushtet e një kontrate të shpërblyer”, dhe neni 61.22 thotë se “ndryshimi i kontratës do të përgatitet nga departamenti i prokurimit”, ndërsa neni 61.23 thotë se kjo mund të bëhet “vetëm pas marrjes</p>	<p>Kryetari duhet të sigurojë se çdo ndryshim në kushtet e kontratës para ose gjatë periudhës së zbatimit do të bëhet vetëm pas njoftimit dhe marrjes së aprovimit nga zyra e prokurimit dhe ZKA.</p>	<p>Ne do të intensifikojm kontrollat dhe për çdo ndryshim në kontratë do të mirret aprovimi nga Zyrtari Kryesor Administrativ .</p>	<p>Menaxheret e Kontratave dhe Zyra e Prokurimit</p>	<p>Viti 2021</p>

<p>së aprovimit nga Zyrtari Kryesor Administrativ" Gjatë testimit të pagesave ne kemi identifikuar katër (4) kontrata në të cilat kishite pasur devijime apo ndryshime të sasive të realizuara nëpër disa pozicione, duke ritur apo zvogëluar sasinë e kontraktuar (me reflektim financiar prej 2€ deri në 3,033€), por pa ritur çmimin total të kontratës. Për këto ndryshime nuk ishin marrë aprovimet e nevojshme nga zyra e prokurimit dhe nga ZKA ashtu siç kërkohet me nenet 61.22 dhe 61.23 të RrUOP. Përkatesisht kontratat: • "Rregullimi i rjetit të kanalizimeve në fshatrat Baice, Kralkovë dhe Damanak" ndryshimet e sasive janë identifikuar në tetë (8) pozicione; • Lot 1 "Rregullimi i rjetit të kanalizimit në fshatrat Shtuticë dhe Verboc", në 20 pozicione; • "Kanalizimi i ujerave të zeza në Komunën e Drenasit - faza e dytë" në nëtë (9) pozicione; dhe • "LOT II Rregullimi i rjetit te kanalizimit ne fshatrat Abri dhe Terdec" në 15 pozicione. Nevoja për ndryshime kishite ardhur për shkak të mungesës së projekteve ekzekutive dhe kërkesave të banorëve lokal për ndryshime specifike sipas nevojave të tyre. Duhet theksuar se dukuria e mangësisve të tilla në menaxhimin e kontratave ishte</p>			
---	--	--	--

	<p>paraqitur edhe në raportin e auditimit të vitit paraprak.</p>				<p>Në fund të vitit 2021.</p>
<p><b>Cështja B3-</b></p>	<p><b>Mangësi në regjistrin kontabël të pasurive si dhe procesin e inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive jo financiare.</b> Neni 6.3 i Rregullores për 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare thotë se: Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK, ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin e-pasuria. Neni 19.4.3 i Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare përcakton se çdo fundvit duhet të bëhet krahasimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen e regjistruar të pasurive jo financiare. Ndërsa neni 21 i po kësaj rregulloreje ka përcaktuar kërkesat për vlerësimin e pasurive jo financiare. Ne kemi evidencuar 14 pagesa të shpenzimeve kapitale dhe jo kapitale prej 489,283€ të cilat nuk ishin regjistruar në regjistrin e pasurive jo financiare (prej tyre 11 pagesa me vlerë 376,842€ nuk janë regjistruar në SIMFK dhe tre (3) pagesa prej 112,441€ në epasuria). Procesi i inventarizimit të pasurive jo financiare ishte kryer me vonesë, rrejdhimisht nuk ishte bërë krahasimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare para datës së përgatitjes së</p>	<p>Kryetari, duhet të sigurohet që do të bëhet azhurnimi i regjistrit të pasurive kapitale konform gjetjeve të auditimit të trajtuara me lartë për të siguruar se të gjitha pasuritë e komunës janë identifikuar dhe regjistruar saktë në regjistrat përkatës të pasurive komunale. Po ashtu duhet siguruar se procesi i inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive do të kryhet sipas kërkesave të Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore, si dhe më pas, të bëhet krahasimi i rezultateve të inventarizimit me gjendjen kontabël të pasurive, duke i sqaruar të gjitha diferencat.</p>	<p>Komuna ka ndermarrë të gjitha masat që për çdo fund viti të bëhet krahasimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen e regjistruar të pasurisë dhe E-pasurisë.</p>	<p>Komisionet e inventarizimit, zyrtari i Pasurisë, dhe zyrtaret e E-pasurisë.</p>	

<p>PFV-ve. Si rezultat, nuk dihet diferenca mes gjendjes se kontabilitetit dhe inventarizimit. Po ashtu, nuk ishte bëre vlerësimi i pasurive jo financiare sipas kërkesave të Rregullores 02/2013. Sipas zyrtarëve komunal, kjo gjendje ishte për shkak të vullmit të madh të punëve në fund të vitit, vonesave në procesin e inventarizimit si dhe mungesës së njohurive lidhur me kërkesat e rregullores për menaxhimin e pasurive, ndonëse kjo gëshje është trajtuar edhe në auditimin paraprak.</p>				
<p><b>Cështja B4-</b>  <b>Dobësi në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme (LLA).</b>          Arkëtimi i të hyrave bëhet sipas afateve kohore të përcaktuara në faturë për secilin lloj të të hyrave. Pjesa më e madhe e LLA i takon tatimit në pronë në vlerë 1,656,643€ apo rreth 49,55%, taksa komunale në biznes në vlerë 1,304,801€ apo rreth 39%, shfrytëzimi i pronës publike (qiraja) në vlerë 356,459€ rreth 10.66% si dhe për leje ndërtimore në vlerë 25,260 rreth 0.76%. Komuna nuk kishite menaxhim efektiv në mbledhjen e të arkëtueshmeve pasi që vazhdon rritja e tyre vit pas viti. Në krahasim me vitin paraprak rritja ishte rreth 193,697€. Rritja e llogarive të arkëtueshme vit pas viti ishte për shkak të mos marrjes së të gjitha veprimëve të mundshme për</p>	<p>Kryetari të sigurojë përmirësimin e procesit të menaxhimit të llogarive të arkëtueshme në mënyrë të rritjes së efikasitetit në arkëtimin me kohë të llogarive të arkëtueshme, duke mos përjashtuar edhe masat juridike.</p>	<p>Do të identifikohen veprimet nga bashkëpunime në mesë të Drejtorateve dhe ZKTP për pezullimin e shërbimeve komunale. Koordinim i plotë me DTP për vazhdimin e procedurave për të përmbarnesit. Dërgimi i vërejtjeve të fundit për page-sën e borxheve nga ZTPR. Paralajmrimi për masat ndëshkuese, për mospagesë të TPR, nëpërmjet mediave të shkruara dhe atyre elektronike.</p>	<p>Zyrtarët në ZKTP</p>	<p>Synojmë që brenda periudhës 2021-2022, të ulim nivelin e të arkëtueshmeve.</p>

	<p>arkëtimin e tyre. Ndonëse niveli i arkëtimit ishte edhe si rezultat i ndikimit të pandemisë, gjithashtu komuna kishte liruuar bizneset nga taksa për ushtrimin e veprimtarisë për vitin 2020.</p>		<p>Është bërë akti-vizimi i programit të ri për menaxhim-in e të hyrave/ llog-ri-ve të arkëtueshme të taksave në biznes. Sa i përketë tfaqim-it të borxheve të vj-etra dhe disa për bi-znese jo aktive do të dalim me një pr-opozim konkret li-dhur me trajtimin e kësaj çështje.</p> <p>Koordinim me Dre-ji-oratin e Inspeki-onit për verifikim të bizneseve dhe zhvi-llimin e procedura-ve për inkasim të borxheve në bazë të rregulloreve në fuqi . Masë tjetër do të jetë dërgimi i vërej-tjeve të fundit për pagesën e borxheve ,si dhe do të anga-zhohemi që borxhet t'i inkasojmë përmes masës për-mbarimore. Me rre-gullore janë parapar masa përmbarimore për shkak të pande-misë nuk janë mbl-edhur borxhet, si dhe si lehtësim për</p>	<p>*Shefi i DZHE-së dhe drejtorja për planifikim urban dhe mbrojtje të mjedisit.</p>
--	--	--	---	--

<p>Çështja B5-</p>	<p><b>Mangësi në listën e detyrimeve kontingjente.</b> Sipas Rregullores së MF-Nr.01/2017 Për Pasqyrat Financiare të Organizatave Buxhetore, neni 18 përcakton se: Organizatat Buxhetore në harmoni me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP) raportojnë të gjitha detyrimet kontingjente. Kemi evidentuar tre (3) raste në shumë 6,607€ të cilat në listën e detyrimeve kontingjente nuk kishin të përcaktuar vlerën financiare, rrjedhimisht vlera e detyrimeve kontingjente e shpalosur në PFV ishte e nënvlerësuar për këtë vlerë. Po ashtu, në kuadër të detyrimeve kontingjente, ishin përfshirë edhe detyrimet prej 78,674€ për të cilat ekzistonte një vendim i formës së prerë nga ana e gjykatave lidhur me to dhe se pritej vetëm ekzekutimi i pagesave nga Thesari. Kjo gjendje ishte për shkak të mungesës së komunikimit të mirëfilltë mes zyrtarëve ligjor të komunës dhe Avokaturës Shtetërore (si përfaqësues i komunës) dhe sektorëve tjerë brenda komunës për evidentimin dhe regjistrimin e saktë të detyrimeve kontingjente.</p>	<p>Kryetari duhet të sigurohet se zyra ligjore dhe e financave bashkëveprojnë në mënyrë sistematike me Avokaturën Shtetërore për të siguruar shpalosje të plota dhe të sakta të detyrimeve kontingjente.</p>	<p>ushtrimin e veprimtarisë janë liruar nga taksa për ushtrim të veprimtarisë 2020.</p> <p>Në të ardhmen planifikohet vëgjimencë e situuar në këtë derjtim, përkatësisht planifikohet që të kërkohen detaje më të hollësisht nga ana e Avokaturës Shtetërore rreth të dhënave për detyrimet kontingjente dhe njëkohësisht kontrole dhe diskutime paraprake me zyrtarët përgjegjës të DBF-së, Arsinit dhe Shëndetësis, për lëndët në procedure, të cilat konsistojn me fushiveprimtarin e tyre në kuadër të drejtorisë. Parapriakisht para se të procedohet me këto të dhëna nga ana e tyre, në</p>	<p>Zyra Ligjore</p>	<p>Gjatë vitit 2021.</p>
--------------------	--	--	--	---------------------	--------------------------

			<p>menyri që të dhënat e shpalosura rreth detyrimeve kontigjente të jenë të sakta dhe pa mangësi eventuale të cilat mund të paraqiten.</p>		
<p><b>Çështja B6-</b></p>	<p><b>Mos kompletimi i NJAB.</b> Neni 5.1.1 i Rregullores 01/2019 për themelimin e Njësise së Auditimit të Brendshëm përcakton që çdo subjekti i sektorit publik me buxhet mbi shtatë (7) milion euro duhet të ketë së paku tre auditorë. NJAB në Komunën e Glllogocit përbëhet nga drejtori dhe një anëtar. Kjo gjendje ishte për shkak mungesës së buxhetit të ndarë për plotësimin e numrit minimal të auditorëve sipas kërkesave ligjore.</p>	<p>Kryetari, duhet të sigurojë se për pozitat e kërkuara do të bëhen planifikimet buxhetore me kohë dhe se NJAB të plotësohet me staf të mjaftueshëm sipas rregullores për themelimin e NJAB.</p>	<p>Planifikimi ekzistues, por mundësit e buxhetit nuk na lejojnë ta shtojmë stafin duke u bazuar në 2 (dy) bazaret e MFPT- qarkoret e Poashu nga viti 2019 nuk është lejuar asnjë rekrutim i ri. Në momentin që kjo të lejohet, ne do të iniciojmë procedurat e rekrutimit.</p>	<p>ZKA/Drejtori i NJAB/ Zyra e personelit</p>	<p>Viti 2021 -2022</p>



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosova  
KOMUNA GLLOGOC  
Zyra e Kryetarit

Nr. 400-40843 dt. 24.08 /2021

Në bazë të nenit 11,12 dhe 40.40.2 nën b dhe c të ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale si dhe në bazë të nenit 8 të ligjit për Financat e Pushtetit Lokal 03/L-049 si dhe nenit 34.6 nën b dhe c të Statutit të Komunës së Drenasit , Kuvendi i komunës në mbledhjen e vetë të mbajtur me datën \_\_\_\_\_ 2019, miratoi këtë:

**PROPOZIM VENDIM  
PËR RIDESTINIM TË MJETEVE**

Neni 1.

Më këtë vendim, miratohet ridestnimi i mjeteve për shpenzime kapitale në programin buxhetor Drejtorati për Infrastrukturë Publike

Neni 2 .

Ridestnimi i mjeteve bëhet nga këto projekte kapitale me këto shuma :

1. **Mbikqyrja e projekteve kapitale ne KK Drenas me kod 48685 në shumë prej: 5,000.00€**
2. **Hartimi i projektit të fizibilitetit për nxemjen qendrore me kod 49249 në shumë prej 50,000.00€**
3. **Zgjerimi dhe ndërtimi i sheshit “Fehmi e Xheva Lladrovci” me kod 49297 në shumë prej 150,000.00€**
4. **Asfaltimi rruges Llapushnik Berishë me kod 49299 në shumë prej 5,000.00€**
5. **Rregullimi i shtratit të lumit Drenica dhe Verbica me kod 48254 në shumë prej 25,000€**
6. **Asfaltimi i rruges në fshatin Llapushnik Poterk- Vukoc me kod 48656 në shumë prej 25,000.00€**
7. **Infrastruktura në Komoran I, II, III dhe IV me kod 48628 në shumë prej 38,000.00€**
8. **Asfaltimi i rruges në fshatin Arllat, Negroc, Gjergjicë, Bytyq me kod 48646 në shumë prej 13,000.00€**

**Totali: 311,000.00€**

Neni 3.

Ridestnimi i mjeteve nga neni 1 i këtij vendimi ridestnohen në këto projektet kapitale:

1. **Rehabilitimi dhe Rikonstruimi i rrjetit të kanalizimit me kod 49189 në shumë prej: 85,000.00€**
2. **Asfaltimi i rruges në fshatin Sankoc dhe Fushticë me kod 48648 në shumë prej 16,800.00€**
3. **Asfaltimi i rrugës në fshatin Baicë, Krajkovë, Damanek me kod 48640 në shumë prej 47,000.00€**
4. **Asfaltimi i rrugës në fshatin Terstenik I dhe II me kod 48633 në shumë prej 15,000.00€**
5. **Kanalizimi i ujërave të zeza dhe atmosferike Drenasin 1,2,3,4 me kod 48693 në shumë prej 20,000.00€**
6. **Kanalizimi i ujërave të zeza në fshatin Abrin e Eperme Terdec me kod 48709 në shumë prej 10,000.00€**
7. **Asfaltimi i rrugës në fshatin Zabel i Ulet dhe Eperm, Korrotic e Ulet dhe Eperme me kod 48658 në shumë prej 26,000.00€**
8. **Rregullimi i infrastruktures trotuar dhe ndriqim publik në Komunën e Drenasit me kod 48617 në shumë prej 55,636.00€**
9. **Asfaltimi i rrugës Dobroshec, Çikatovë e Vjetër me kod 48638 në shumë prej 35,564.00€**

**Totali: 311,000.00€**

Neni 4.

Ky vendim hynë në fuqi ditën e aprovimit nga ana e kuvendit komunal të Drenasit dhe për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesën: Kryetari i Komunës, Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Drejtorati për Infrastrukturë Publike.



Kryetari i Komunës



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
**Komuna Glogoc**  
Zyra e Kryetarit



01-Nr 462/01-40827 dt. 24.08 2021

Në bazë të nenit 58, pika h të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 72 pika h e Statutit të Komunës së Glogocit, nenit 13 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 6 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë \_\_\_\_\_ 2021, të miratoj këtë:

### **PROPOZIM VENDIM**

Për miratimin e listës së veçantë të pronave të paluajtshme të komunës që planifikohen për dhënien në shfrytëzim afatgjatë në vitin 2022

#### **Neni 1**

Kuvendi i Komunës së Glogocit të miratoj listën së veçantë të pronave të paluajtshme të komunës që planifikohen për dhënien në shfrytëzim afatgjatë në vitin 2022.

#### **Neni 2**

Pronat e paluajtshme të Komunës së Glogocit të propozuara për dhënie në shfrytëzim afatgjatë në vitin 2022, janë pjesë e këtij vendimi sipas listës së bashkangjitur.

#### **Neni 3**

Procedura për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë duhet të jetë në përputhje të plotë me Ligjin Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të

Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, si dhe legjislacionin tjetër në fuqi.

Dhënia e pronave të lartcekura në shfrytëzim afatgjatë, ka për qëllim zhvillimin ekonomik dhe interesin publik të komunës së Drenasit.

#### **Neni 4**

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen, Kryetari i Komunës, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

#### **Neni 5**

Ky Vendim hyn në fuqi pas aprovimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Glllogocit.



Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci

### **ARSYETIM**

Komuna e Drenasit duke u bazuar në faktin se me dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të Komunës do të krijohen kushte për zhvillim të bizneseve, krijimin e mundësisë për investime nga investitorët vendor dhe të huaj me ç'rast do të krijohen vende të reja të punës, dhe do të ndikohet në rritjen e zhvillimit ekonomik në komunë.

Me dhënien e pronës komunale në shfrytëzim sipas dispozitave ligjore në fuqi, Komuna do të inkason edhe të hyra komunale të cilat konsiderohen para publike dhe i nënshtrohen dispozitave ligjore për menaxhimin e financave publike.

Andaj ashtu siç e parasheh nenit 13 i Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 6 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, kërkohet të miratohet lista e veçantë e pronave të paluajtshme të komunës, që parashihet të ipen në shfrytëzim afatgjatë në vitin 2022.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komuna Glogoc  
Zyra e Kryetarit



01-Nr 462/01-40827 dt. 24.08 2021

Paraqitja tabelare e listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës së Drenasit, të cilat planifikohen të ipen në shfrytëzim afatgjatë gjatë vitit 2022

Nr.	NGASTRA KADASTRALE	SIPËRFAQJA (m <sup>2</sup> )	ZONA KADASTRALE	DESTINIMI (PZH-K-Harta Zonale)
1	PJESË E PARCELËS 726/15	13200	GLOGOC	Shërbim Tregtar Komercial, Ndërtimore
2	PJESË E PARCELËS 4 /111	26104	KOMORAN	Shërbim Tregtar Komercial, Ndërtimore
3	00438/4	2559	GLOBAR	Shërbim Tregtar Komercial, Ndërtimore
4	00438/5	1838	GLOBAR	Shërbim Tregtar Komercial, Ndërtimore
5	00034/0	8128	Korroticë e Epërme	Shërbim Tregtar Komercial, Ndërtimore
6	00878-5	4259	GLOGOC	Shërbim Tregtar Komercial, Ndërtimore
7	00758-1	1852	GLOGOC	Shërbim Tregtar Komercial, Ndërtimore
8	PJESË E PARCELËS 00743/29	19815	GLOGOC	Shërbim Tregtar Komercial, Ndërtimore
9	PJESË E PARCELËS 00414, 00430, 00436, 00435, 00434, 00433, 00431	5188	GLOGOC	Shërbim Tregtar Komercial, Ndërtimore
10	01981/0	3263	KOMORAN	Shërbim Tregtar Komercial, Ndërtimore
11	00244/3	1930	KOMORAN	Shërbim Tregtar Komercial, Ndërtimore
12	00244/4	2000	KOMORAN	Shërbim Tregtar Komercial, Ndërtimore
13	00244/5	1619	KOMORAN	Shërbim Tregtar Komercial, Ndërtimore

R-00

14	01980/0	2003	KOMORAN	Shërbim Tregtar Komerical, Ndërtimore
15	Pjesë e parcelës 02652/4	3232	ARLLAT	Shërbim Tregtar Komerical, Ndërtimore
16	Pjesë e parcelës 140/0	21241	Polluzhë	Tokë Bujqësore
17	Pjesë e parcelës 140/1	27063	Çikatovë e Re	Shërbim Tregtar Komerical, Ndërtimore
18	Pjesë e parcelës 768/2	2044	Glllogoc	Shërbim Tregtar Komerical, Ndërtimore
19	Pjesë e parcelës 767/2	2500	Glllogoc	Shërbim Tregtar Komerical, Ndërtimore
20	Pjesë e parcelës 767/5	1639	Glllogoc	Shërbim Tregtar Komerical, Ndërtimore
21	Pjesë e parcelës 726/17	57947	Glllogoc	Shërbim Tregtar Komerical, Ndërtimore
22	1/8	1000	Komorani	Shërbim Tregtar Komerical, Ndërtimore
23	1/13	1110	Komorani	Shërbim Tregtar Komerical, Ndërtimore
24	Pjesë e parcelës 14/0	470707	Glllobar	Pyjore/Kullosë
25	Pjesë e parcelës 768	1970	Glllogoc	Shërbim Tregtar Komerical, Ndërtimore
26	144/0	9328	Cikatove e Re	Shërbim Tregtar Komerical, Ndërtimore

Drenas,

24.08.2021



Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
**Komuna e Glllogocit**  
Zyra e Kryetarit



**01-Nr 400-40838 dt. 24.08 2021**

Në bazë të nenit 11, nenit 16 të Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, nenit 4 paragrafi 3 nënparagrafi 3.2, nenit 8 paragrafi 4 të Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr.05/2014 për pjesëmarrjen e publikut në Planifikimin Hapësinor, në bazë të nenit 58 pika (h) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 72 paragrafi 1 pika (h) të Statutit të Komunës së Glllogocit, Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës, të miratoj këtë:

**PROPOZIM VENDIM**  
**PËR SHQYRTIMIN PUBLIK I NDRYSHIMEVE TË PROJEKT- HARTËS ZONALE TË**  
**KOMUNËS SË GLLOGOCIT PËR PERIU DHËN 2021-2029**

**Neni 1**

Kuvendi i Komunës së Glllogocit të miratoj vendimin për shqyrtimin publik të ndryshimeve të Projekt- Hartës Zonale të Komunës së Glllogocit për periudhën 2021-2029.

**Neni 2**

Me këtë Vendim autorizohet dhe obligohet Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit si autoritet përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor, që të përgatitë plotësim ndryshimet e projekt- Hartës Zonale të Komunës së Glllogocit 2021-2029, dhe të vazhdojë me procedurat e tjera ligjore, në harmoni me legjislacionin në fuqi dhe në koordinim të plotë me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

**Neni 3**

Shqyrtimi publik i ndryshimeve të Projekt-Hartës Zonale të Komunës së Glllogocit 2021-2029, zgjat 15 ditë, sipas procedurave të përcaktuara me ligj.

**Neni 4**

Shqyrtimi publik i ndryshimeve të Projekt- Hartës Zonale të Komunës së Glllogocit 2021-2029, organizohet nga Komuna në kuadër të kompetencave ligjore.

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Neni 6

Ky vendim hyn në fuqi pas aprovimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Glllogocit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së.

Kryetari i Komunës  
Ramiz Lladrovci

